



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 02.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **29.09.2025**, të parashtruar nga GOE **GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit të QKMF Drenas”** me nr. prokurimi 206-25-8016-2-3-6, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K e dt. 29.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit të QKMF Drenas”** me nr. prokurimi 206-25-8016-2-3-6, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 24.09.2025;
2. **Anulohet**, Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 24.09.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në Rivleresim aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K me datën 29.09.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit të QKMF Drenas”** me nr. prokurimi 206-25-8016-2-3-6. Autoriteti Kontraktues me datë 02.10.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

Neni 71 i LPP-së

Neni 26 i RrPP-së

Neni 45.29 i RrPP-së

Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pretendimet ankimore te OE ankues - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne si Grup i Operatorëve Ekonomik.; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K; STUDIO HAPSIRA SH.P.K, më datë 09.09.2025 kemi dorëzuar ofertën tonë për aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit te QKMF Drenas”**, ndërsa më datë 24.09.2025, Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, me të cilin ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit.

• Po e bashkangjesim Vendimin e Autoriteti Kontraktues “Njoftim lidhur me vendimin për eliminimin tonë 24.09.2025

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ¹

24.09.2025, Prishtinë

Ministria e Shëndetësisë, rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëri

Grup i Operatorëve Ekonomik GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.; STUDIO HAPSIRA SH.P.K., Ndue Përlleshi B2-1/6- Mat 1, p.n, 10000, Prishtinë

Nr ² i prokurimit	206-25-8016-2-3-6
------------------------------	-------------------

Titulli: **“Hartimi i Ekspertizës profesionale Inxhinierike për vlerësimin e projektit te QKMF Drenas “**

I/e nderuar,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:


- Oferta juaj është papërgjegjshme, pasi që nga lista e projekteve të realizuara vërehet qartë se nuk ka kontrata të realizuara në fushën e kërkuar “projektim ose revidim” në një projekt nga sektori i shëndetësisë (QKMF, objekt spitalor apo klinikë); Po ashtu në listën e Stafit profesional të angazhuar për këtë projekt si Arkitekt i kompanisë Figuron Valon Elshani, ku te njëjtë i mungon CV-ja.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Berat Marmullaku
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)

PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimi 1: Nuk keni kontratën në fushën e kërkuar

Bazuar në Listën e prezentuara të Kontratave në 3 vitete e fundit- Ne kemi markuar me ngjyrë të verdhë kemi specifikuar se cilët kontrata i kemi realizuar sipas natyrës se FDT-së

Frutë me 2 Rërsi							
27	Hartimi i dokumentacionit teknik të detajuar-projekte të detajuar (Projektimi i Renovimit të Qendrës Spitalore në Bili të Poshtme, dhe Projekte të QKMF, QMF, AMF etj.)	03.06.2022	Vazhdon	120,000.00€ (Vlera e Projekteve deri me tani rreth 63,000.00 euro)	KK Shterpcë	krunislavz25@gmail.com	
49	Hartimi i Projekteve për Ndërtim të Lartë (Projektimi i Mbrojtjes në QKMF dhe Garazh në QKMF dhe Objekte tjera)	01.08.2022	31.01.2025	79,476.10€	KK Prishtinë	burbuqe.agushi@rks-gov.net	
50	Hartimi i Projektit për Renovimin e Objekteve Egzistuese të ISSH dhe SHFAKM dhe Rregullimi i Sallës së Fizioterapisë në ISSH	27.05.2024	27.06.2024	949,99€	Ministria e Shëndetësisë	Berat.Marmullaku@pks-gov.net	
51	Hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë	20.06.2024	21.10.2024	7,899.00€	Ministria e Shëndetësisë	Berat.Marmullaku@pks-gov.net	

Në rastin Konkrete Vendimin imbi eliminimin tonë është absurd ku ne kemi krye projektet me qertifikatat të projektimit pikërisht në Ministrin e shëndetësisë dhe janë lëshuar edhe certifikatat pozitive pranimit punëve dhe janë kryer edhe me suksesë pagesat.

Në rastin Konkret Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me NENI 59

Neni 59

Egzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

AK i ka ikur një kriteri të tillë .

PROVË:



Për: Zyra e prokurimit publik
Komuna Shtëpcë

Od: Aleksandar Nešić
Menaxheri i kontratës me vendim me numër protokoll 02-030/01-3199/23 datë 14.03.2023.

Lënda: Raport mbi shërbimet e kryera

Bazuar në Kornizën Marrëveshjes Publike 655-21-8239-2-2-1/C133 me numër protokoll 02-030/01-7298/22 nga data 03.06.2022. e lidhur në mes të Komunës së Shtëpcës nga njëra anë dhe Sh.P.K "Studio Hapsira" nga ana tjetër për ofrimin e shërbimeve Hartimi i dokumentacionit teknik të detajuar-projektet e detajuara, Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës me numër protokoll 02-030/01-3199/23 të datës 14.03.2023., si dhe raporti e Komisionit për pranimin e shërbimeve me numër protokoll 06-030/01-13999/23 të datës 27.11.2023., në të cilin thuhet "...se është dorëzuar dokumentacioni teknik i detajuar në përputhje me detyrën dhe kontratën e projektit..." dhe janë shpjeguar shërbimet e kryera për hartimin e dokumentacionit teknik të detajuar për projektin "Ndërtimi i kultimit dhe renovimi i objektit ekzistues të qendres spitalore në Biti te poshtme", është konstatuar se janë dorëzuar 3 (tre) kopje fizike dhe 1 (një) kopje digjitale të dokumentacionit teknik të hartuar në përputhje me kontratën, si dhe mund të inicohet procedurë e mëtejshme për pagesën e shërbimeve të kryera në vlerë prej 7,425.22 euro.

T'i dorëzohet:

- Arkivit komunal;
- Drejtorisë së Prokurimit Publik;
- Kompanisë së kontraktuar;
- Drejtorisë së Urbanizmit.

Menaxheri i kontratës:
Aleksandar Nešić



Në kuadër listës kemi dorëzuar Projektin me certifikat pranimi : Ndërtimi kulmit dhe renovimi i objekti ekzistues Qendrës Spitalore në Biti Poshtme Komuna Shtëpcës e cila është lëshuar me datën 27.11.2023 dhe është brenda 3 viteve nga njoftimi për kontrata dhe plotëson kërkesat e përshmtashmërisë së FDI.

Neni 60
Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

AK i ka ikur një kriteri të tillë , pasi në shumicën e Lloteve kemi qenë oferta e përgjegjshme më e lirë për kundës që kriter i FDT ka qenë Çmimi i i lirë.

Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

Autoriteti Kontraktues i ka ikur një kriteri të tillë pasi nuk ka kërkuar sigurimin e informtave për qarkullimin bankarë.

Pretendimi 2: Mungon CV- Arkitektitë Valon Elshani

Bazuar në Udhëzuesin:

**UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR
PROKURIMIN PUBLIK**

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 *Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së*

CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohej informata sqaruese	69
------------------------------------	-------------------------------------	----

Autoriteti ka Vepruar në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ prkurimit Publik 001/2023 , paragrafi 10 (Sqarimi i tenderëve) ,po ashtu AK ka vepruar në Kundërshtim edhe NENI 69 LPP-së.

Rregullorja 0021/2022 për Prokurim Publik

45.29 Për tenderët që plotësojnë kërkesat në lidhje me përgjegjshmërinë formale, kushtet teknike, përshkrimin dhe specifikimet e dosjes së tenderit, dhe vlersimin financiar, autoriteti kontraktues do të vazhdojë për të vlerësuar/verifikuar përshtatshmërinë, dhe nëse është e aplikueshme, kualifikimet e ofertuesve sipas kriterëve të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, në bazë të provave të nevojshme dokumentuese.

Ak i ka ikur një kriteri të tillë.

Përfundimisht kjo mënyrë e eliminimit të aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe tejet arbitrare dhe si e tillë duhet të parandalohet nga OSHP si organ më i lartë vendimmarrës.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, **Autoriteti Kontraktues**, i propozojmë që të merr këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** tërësisht e bazuar Ankesa e parashtruar nga OE GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.
- II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 26.09.2025, ashtu që **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**, që lëndën ta kthej në **RIVLERËSIM** dhe pas rivlerësimit OE GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K SH.P.K. të shpallet fituese si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne si OE kemi pësuar dëme të konsiderueshme. Dëmet e pësuar (materiale dhe jo materiale) deri në këtë fazë të procedurës janë në vlerë 5,000 euro.

Activate

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimi juaj është i bazuar.

Oferta juaj është refuzuar meqenëse bazuar në kriterin e DT të kriteri nr. 1 është kërkuar: **OE duhet të dëshmojë së ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të ngjashme (projektim ose revidim) në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë në vlerë prej 15,000.00 Euro. Të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë (QKMF, objekt spitalor apo klinikë)**

Në listën e projekteve ju e keni prezantuar kontratën me KK Shtërpçë e cila ende është në vazhdim, andaj duke marrë parasysh kërkesën se OE duhet të dëshmojë së ka përfunduar me sukses kontratë, komisioni vlerësues nuk e ka marrë parasysh as projektin e juaj për Qendrën Spitalore në Biti të Poshtme.

rruge me Z Korsi							
27	Hartimi i dokumentacionit teknik të detajuar-projekte të detajuar (Projektimi i Renovimit të Qendrës Spitalore në Biti të Poshtme, dhe Projekte të QKMF, QMF, AMF etj.).	03.06.2022	Vazhdon	120,000.00€ (Vlera e Projekteve deri me tani rreth 63,000.00 euro)	KK Shtërpçë	krunislavz25@gmail.com	

Pas Kërkeses tuaj për rishqyrtim, e kemi analizuar edhe një herë lenden dhe duke marrë parasysh rëndësinë e projektit, edhe pse kontrata me KK Shtërpçë ende është në vazhdim, por meqenëse është kontratë kornizë e cila në vetvete përmban disa projekte, atëherë projektin e juaj për Qendrën Spitalore në Biti të Poshtme, e pranojmë si projekt që është realizuar.


Ndërsa projektet tjera për Mbistrehen e QKMF dhe Garazhave, Salla e Fizioterapise në ISSH, si dhe projekti i Depos së Barnave, nuk e mbulojnë kërkesën e tenderit për kategorinë e kërkuar (QKMF, objekt spitalor apo klinikë).

Gjithashtu edhe sa i përket CV se prezantuar, me Kërkesën për Rishqyrtim, të arkitektit Valon Elshani, bazuar në UOPP nr. 002/2024 e pranojmë se e keni plotësuar edhe këtë kërkesë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit